

**V E N D I M**  
**Nr. 443, datë, 16.9.1999**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**NR. 786, DATË 17.12.1998 “PËR KUALIFIKIMIN SHKENCOR, PASUNIVERSITAR DHE**  
**KLASIFIKIMIN E PUNONJËSVE PEDAGOGJIKË E KËRKIMORË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 37 të ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 17.12.1998 “Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë”, pas pikës 4.2.4 shtohen pikat 4.2.5, 4.2.6 dhe 4.2.7, me këtë përmbajtje:

“4.2.5 Në Akademinë e Arteve, kualifikimi për kategoritë e punonjësve pedagogjikë të lëndëve teorike bëhet në përputhje të plotë me pikat 4.1, 4.2, 4.2.1, 4.2.2, 4.2.3 dhe 4.2.4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 17.12.1998 “Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë”.”.

“4.2.6 “Profesor”, për lëndët speciale artistike, në Akademinë e Arteve emërohet punonjësi me një përvojë në mësimdhënie jo më pak se 14 vjet, që ka një krijimtari të shquar artistike në vazhdimësi, që është hartues programesh për lëndë ose gruplëndësh të formimit profesional, që ka drejtuar ose drejton njësi mësimore (seksion, departament, dekanat, etj.), që është autor leksionesh të shkruara ose bashkautor manualesh për Akademinë e Arteve, që ka përzgjedhur, formuar e diplomuar studentë, që tashmë shquhen për arritje në krijimtarinë artistike, brenda dhe jashtë vendit, që ka udhëhequr diploma universitare, që zotëron një gjuhë të huaj, të vërtetuar me dëshminë përkatëse, që është realizues figurash dhe veprash artistike, të gjinisë së skenës dhe të ekranit, të vlerësuara si arritje të artit tonë kombëtar (arti skenik), që ka organizuar ekspozita personale, të cilat dëshmojnë cilësi dhe nivel të lartë artistik (artet figurative), që është realizues veprash artistike, të gjinisë së muzikës, të vlerësuara si arritje të artit tonë kombëtar (muzikë), që është fitues medaljesh dhe çmimesh në krijimtari, që ka marrë pjesë, me projekte artistike, në veprimtari të rëndësishme, kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë 14 vjetëve të punës pedagogjike punonjësi mësimor-artistik duhet të ketë qenë lëvrues e realizues i jo më pak se 7 projekteve të spikatura artistike. Disa nga projektet e përcaktuara të jenë të realizuara në Akademinë e Arteve (artet figurative në Galerinë e Arteve dhe galeri të tjera, të niveleve të përafërta).”.

“4.2.7 “Profesori asociuar”, për lëndët speciale artistike, emërohet punonjësi me përvojë në mësimdhënie prej jo më pak se 10 vjetësh, që ka një krijimtari cilësore, artistike, që është hartues programesh për lëndë apo gruplëndësh të formimit profesional, që ka drejtuar ose drejton, si titullar, lëndë ose gruplëndësh të profesionit, që është hartues studimesh për problemet e fushës përkatëse, artistike (sipas specialitetit), që ka udhëhequr diploma universitare, që zotëron një gjuhë të huaj, të vërtetuar me dëshminë përkatëse, që është realizues figurash dhe veprash artistike të gjinisë së skenës dhe të ekranit, në nivele cilësore artistike (arti skenik), që ka organizuar ekspozita personale në Galerinë e Arteve dhe në galeri të tjera (arti figurativ), që është realizues veprash artistike në gjininë e muzikës, në nivele cilësore artistike (muzike), që ka realizuar 5 figura apo vepra artistike, të vlerësuara nga kritika për nivel të lartë artistik, që është vlerësuar me çmime të ndryshme në veprimtari kryesore, kombëtare ose ndërkombëtare, që krijimtaria e tij ka qenë e pranishme në procesin mësimor të Akademisë së Arteve dhe shkollave të tjera artistike, të niveleve të përafërta.”.

2. Në pikën 4.3.1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

“ - Shprehja “... prej jo më pak se 5 vjetësh...” hiqet dhe zëvendësohet me shprehjen “...prej jo më pak se 4 vjetësh...”.”.

- Shprehja “... të paktën dy disertacione...” hiqet dhe zëvendësohet me shprehjen “... të paktën një disertacion...”.”.

- Shprehja “... nga të cilat 5 jashtë shtetit...” hiqet dhe zëvendësohet me shprehjen “... brenda e jashtë shtetit ...”.”.

3. Në pikën 4.3.2 bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

“ – Shprehja “... nga të cilat 3 jashtë shtetit ...” hiqet dhe zëvendësohet me shprehjen

“... brenda e jashtë shtetit...”.”.

4. Në pikat 4.5, 4.6, 4.7, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 17.12.1998, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

“ – Shprehja “Këshilli Drejtues i Akademisë” hiqet dhe zëvendësohet me shprehjen në “seksione përkatëse”.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
**Pandeli Majko**